

MISIONI PËR SHPËTIMIN E KOPSHTIT

Lufta kundër Pesti-t, parazitit të bimëve



Njihuni me familjen Martini. Ata janë një familje që jeton në Shqipëri, njësoj si familja juaj dhe e imja. Gjysh Henrik-u e adhuron kopshtin e tij. Ai është i mbushur plot e përplot me kujtime të çmuara dhe perime të freskëta. Mbesës së tij të madhe, Zhanet-ës, dhe vëllait të saj të vogël, Teo-s, u pëlqen shumë ta ndihmojnë gjyshin. Ata kënaqen duke ujitur dhe krasitur për t'i dhënë kopshtit gjallëri.



Vitin e fundit, Zhanet-a ka qenë me studime jashtë shtetit. Teksa bëhet gati për t'u kthyer në shtëpi, i lind një ide e shkëlqyer! Gjatë shëtitjes së saj të fundit në pyll, ajo sheh një lule ekzotike dhe vendos ta marrë me vete në shtëpi, si dhuratë për gjyshin e saj. E këput lulen pa u menduar dy herë.



Ndërkohë që Zhanet-a bën gati çantën e saj, Pesti (Paraziti) qëndron i fshehur brenda bimës me një nënqeshje të djallëzuar. – *Sa qejf është të udhëtosh falas dhe të bësh kërdinë në vende të reja!* – mendon ai.




Familja është shumë e lumtur që janë përsëri të gjithë së bashku. Zhanet-a u tregon historitë e aventurave të saj dhe i jep gjysh Henrik-ut bimën ekzotike. Ajo nuk e di se së bashku me bimën, ka sjellë në shtëpi edhe diçka që nuk ia pret mendja!



Familja i bashkohet gjysh Henrik-ut në kopsht, ku ai ka mbjellë bimën e re ekzotike. Bima duket e mrekullueshme, por askujt nuk ia merr mendja që Pesti ka një plan djallëzor. Pesti nënqesh me vete teksa vërtitet rreth kopshtit, duke zgjedhur viktimën e radhës!



Ka ardhur ora e darkës për Pesti-n. Çdo bimë që ai prek ose ha fillon të vyshket, ndërkohë që Pesti sa vjen e bëhet më i fortë dhe qesh me të madhe. Oreksi i tij nuk ka të sosur. Pesti shkatërron gjithçka, sepse ky është hobi i tij më i madh... prandaj ai duhet zhdukur një orë e më parë nga kopshti i gjysh Henrik-ut!



Pas disa ditësh, Zhanet-a dhe Teo shkojnë për vizitë te gjyshi për të parë si është. Ata e gjejnë të përhumbur në kopshtin e tij, me një pamje të hutuar. Bimët e tij po vyshken dhe parcela e perimeve është një katastrofë.




Teo mendon të thërrasin ekspertët e bimëve. Ekipi vjen për të parë se çfarë po ndodh dhe për të gjetur një zgjidhje. Pesti fshihet, pasi e kupton se plani i tij është zbuluar.



Ekipi i ekspertëve e gjen shpejt problemin. – *Nga ka ardhur kjo bimë?* – pyesin ata, duke treguar me gisht lulen ekzotike. Zhanet-a u thotë se e ka sjellë me vete nga udhëtimet e saj, si dhuratë për gjyshin. Misteri u zgjidh! Ekspertët e kuptojnë se keqbërësi ishte Pesti dhe, tashmë, ai i ka ditët të numëruara. Ekipi nis menjëherë trajtimin e kopshtit. Pesti nis të kollitet e të gulçojë.



Falë përpjekjeve të ekspertëve dhe mjeshtërisë së gjyshit në kopshtari, kopshti shpëton! Familja mbjell bimë të shëndetshme dhe tipike të zonës dhe shumë shpejt kopshti nis të gjallërohet me ngjyra dhe fruta e perime të freskëta. Pesti ka ikur dhe familja nxjerr një mësim të rëndësishëm: sillni në shtëpi fotografi dhe jo bimë nga udhëtimet tuaja jashtë Shqipëri-së!



Bashkohuni me Zhanet-ën dhe Teo-n në një aventurë emocionuese kopshtarie!

Kur Zhanet-a, një adoleshente dashamirëse, sjell në shtëpi një lule misterioze nga studimet e saj jashtë shtetit, ajo sjell pa dashje Pesti-n, një parazit dinak bimësh, në kopshtin e dashur të gjyshit të saj Henrik.

Bimët po vyshken dhe kopshtin e ka pllakosur kaosi. A do ta shpëtojnë dot Zhanet-a dhe Teo kopshtin para se të jetë vonë? Zbuloni se si edhe lulja më e vogël dhe e bukur mund të fshehë një problem të madh.

Jetoni nga afër këtë rrëfim të ngrohtë familjar mbi natyrën dhe punën në grup.



#PlantHealth4Life

